

URDHËR
Nr.485, datë 3.10.2011

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR”,
PROGRAMEVE TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I
SHKENCAVE”, SI DHE HAPJEN E FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE TË ZBATUARA
TË EDUKIMIT NË SHKOLLËN E LARTË PRIVATE “JUSTICIA”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 44/1 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen, në përputhje me vendimin nr.232, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë private “Justicia”, e programeve të studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në:

- a) Jurist në administratë;
- b) E drejtë private, me profile:
 - i) E drejtë biznesi;
 - ii) E drejtë tregtare.

2. Hapjen, në përputhje me vendimin nr.232, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë private “Justicia”, e programeve të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në:

- a) E drejtë civile;
- b) E drejtë penale dhe shkencat penale;
- c) E drejtë publike dhe politikat publike;
- d) Studime në të drejtën europiane.

3. Hapjen, në përputhje me vendimin nr.253, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë private “Justicia”, të Fakultetit të Shkencave Humane të Zbatuara dhe Edukimit.

4. Hapjen, në përputhje me vendimin nr.253, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë private “Justicia”, e programeve të studimit të ciklit të parë bachelor në “Studime për zhvillimin human dhe familjen”.

5. Programet e studimeve, të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri, realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1.5 vite akademike. Në përfundim të tyre lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në fushën e arsimit të kryer.

6. Programet e studimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri, realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike. Në përfundim të tyre lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në fushën e arsimit të kryer.

7. Programet e studimeve të përcaktuara në pikën 4 të këtij urdhri, realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike. Në përfundim të tyre lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në fushën e arsimit të kryer.

8. Programet e studimeve të fillojnë në vitin akademik 2011-2012.

9. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat dhe shkolla e lartë private “Justicia”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj